FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.84 23 korrik 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 73/2012 datë 12.7.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 2 në marrëveshjen e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të ndërtimit të rrugës Levan-Vlorë	4283
Rezolutë e Kuvendit datë 21.6. 2012	Për vlerësimin e punës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive për vitin 2011	4286
Dekret nr. 7579 datë 28.6.2012	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	4287
Vendim i KM nr. 419, datë 27.6.2012	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", të ndryshuar	4288
Vendim i KM nr. 436, datë 11.7.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar	4290
Vendim i GJK nr. 38, datë 5.7.2012	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 00-2011-1117 (191), datë 21.4.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	4290

LIGJ
Nr. 73/2012

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE NR. 2 NË MARRËVESHJEN E HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH) PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË NDËRTIMIT TË RRUGËS LEVAN – VLORË

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese nr. 2 në marrëveshjen e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të ndërtimit të rrugës Levan – Vlorë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 12.7.2012

Shpallur me dekretin nr. 7722, datë 20.7.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Kopje ekzekutive
(Numri i veprimit 37057)

MARRËVESHJE NDRYSHUESE NR. 2

PËR NJË MARRËVESHJE HUAJE TË DATËS 16 NËNTOR 2007, NË LIDHJE ME PROJEKTIN E RRUGËS LEVAN-VLORË, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
të datës_____maj 2012

Kjo Marrëveshje ndryshuese e datës___maj 2012 (më poshtë e quajtur "marrëveshje ndryshuese") lidhet ndërmjet:

1. Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi); dhe

2. Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, një organizatë ndërkombëtare e themeluar me traktat (Banka).

Duke marrë në konsideratë se:

A. Huamarrësi ka lidhur një marrëveshje huaje të datës 16 nëntor 2007, të ndryshuar më pas me një marrëveshje ndryshuese nr. 1, datë 31 mars 2008 (së bashku "Marrëveshja fillestare") me Bankën në lidhje me projektin e rrugës Levan-Vlorë, në pajtim me të cilën Banka ka rënë dakord t'i japë hua Huamarrësit një shumë që nuk kalon 22 000 000 (njëzet e dy milionë euro), (huaja fillestare) sipas dispozitave të Marrëveshjes fillestare.

B. Me shkresën e datës 8 prill 2011, Banka ka rënë dakord të shtyjë datën e fundit të disponibilitetit deri më 31 dhjetor 2012.

C. Huamarrësi i ka kërkuar Bankës të rrisë shumën principale të huas fillestare me 7 500 000 euro (shtatë milionë e pesëqind mijë euro) për të financuar një pjesë të shpenzimeve të tepërta të bëra në lidhje me projektin.

D. Banka ka rënë dakord të rrisë shumën e huas fillestare mbi dhe në pajtim me dispozitat e marrëveshjes ndryshuese.

Kështu, palët bien dakord si më poshtë:

Seksioni 1. Interpretimi

a) Në këtë marrëveshje:

"Ndryshime" janë ndryshimet e bëra ose që duhet t'i bëhen seksionit 2 të kësaj marrëveshjeje ndryshimi.

"Datë e hyrjes në fuqi" ka kuptimin e dhënë në seksionin 3 të kësaj marrëveshjeje ndryshimi.

"Marrëveshje fillestare" ka kuptimin e dhënë në pjesën hyrëse A.

"Hua fillestare" ka kuptimin e dhënë në pjesën hyrëse A.

b) Termat e përkufizuar në marrëveshjen fillestare (drejtpërdrejt apo nëpërmjet referencës në një marrëveshje ose instrument tjetër), përveç kur është parashikuar ndryshe, kanë të njëjtin kuptim në këtë marrëveshje ndryshimi. Dispozitat e seksionit 1.03 (interpretimi) të marrëveshjes fillestare kanë të njëjtin efekt sikur të jenë përcaktuar në këtë marrëveshje ndryshuese, *mutatis mutandis*.

c) Marrëveshja fillestare dhe kjo marrëveshje ndryshuese lexohen dhe interpretohen si një dokument i vetëm.

Seksioni 2. Ndryshimi dhe vazhdimësia

a) Me fuqi në dhe nga data e hyrjes në fuqi, seksioni 2.01 i marrëveshjes fillestare shfuqizohet plotësisht dhe zëvendësohet me sa më poshtë:

"Seksioni 2.01. Shuma dhe monedha

Banka bie dakord t'i japë hua huamarrësit, me kushtet dhe termat e parashikuar ose të referuar në këtë marrëveshje, shumën prej 29 500 000 (njëzet e nëntë milionë e pesëqind mijë euro)".

b) Me fuqi në dhe nga data e hyrjes në fuqi, seksioni 2.02 (e)(2) i marrëveshjes fillestare shfuqizohet plotësisht dhe zëvendësohet me sa më poshtë:

"e) (2) Pavarësisht nga sa më sipër, në rast se: i) Banka e shtyn datën e fundit të disponibilitetit të specifikuar në seksionin 2.02 (f) më poshtë në një datë që bie pas kësaj date të parë të shlyerjes së huas; ose ii) shuma principale e huas shtohet pas datës së parë të shlyerjes së huas, shuma e çdo tërheqjeje të bërë në ose pas datës së parë të shlyerjes së huas, caktohet për shlyerje në shuma të barabarta te të gjitha datat e shlyerjes së huas që bien pas datës së kësaj tërheqjeje (ku Banka përshtat shumat e caktuara sipas nevojës për të arritur shifra të plota në çdo rast). Banka njofton herë pas here huamarrësin për këto caktime.".

c) Me fuqi në dhe nga data e hyrjes në fuqi, seksioni 3 i grafikut 1 të marrëveshjes fillestare (përshkrimi i projektit) ndryshohet duke fshirë fjalët "dhjetor 2010" dhe duke i zëvendësuar ato me fjalët "fundi i gushtit 2012".

d) Me fuqi në dhe nga data e hyrjes në fuqi, tabela në shtojcën e grafikut 2, fshihet tërësisht dhe zëvendësohet me tabelën e parashikuar në grafikun e kësaj marrëveshjeje ndryshuese.

e) Dispozitat e marrëveshjes fillestare, përveç kur ndryshohet nga kjo marrëveshje ndryshuese, vazhdojnë të jenë plotësisht në fuqi.

Seksioni 3. Tarifa e angazhimit dhe komisioni fillestar

Huamarrësi pranon se është i detyruar t'i paguajë Bankës një tarifë angazhimi dhe një komision fillestar, sipas parashikimit në seksionin 3.05 të termave dhe kushteve standarde, si më poshtë:

a) Huamarrësi i paguan Bankës tarifën e angazhimit për shumën e disponueshme (që shtohet në pajtim me këtë marrëveshje ndryshuese) në një normë prej 0.5% në vit. Tarifa e angazhimit mblidhet nga data gjashtëdhjetë (60) ditë pas datës së kësaj marrëveshjeje ndryshuese.

b) Huamarrësi i paguan Bankës një komision fillim-mbarim prej 75,000 euro (shtatëdhjetë e pesë mijë euro), ku kjo shumë është e barabartë me një për qind (1%) të diferencës ndërmjet: i) shumës

principale të huas pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje ndryshuese; dhe ii) shumës principale të huas, sipas marrëveshjes fillestare. Banka, në pajtim me seksionin 3.05 (c) të termave dhe kushteve standarde dhe në emër të huamarrësit, tërheq nga shuma e disponueshme në datën e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje ndryshuese ose brenda shtatë (7) ditësh pas kësaj, dhe i paguan vetes shumën e komisionit fillim-mbarim, që paguhet në pajtim me këtë seksion 3 (b).

Seksioni 4. Data e hyrjes në fuqi

Data e hyrjes në fuqi është data në të cilën përmbushen kushtet e mëposhtme paraprake ose hiqet dorë prej tyre me zgjidhjen e vetme të EBRD-së qoftë plotësisht ose pjesërisht:

a) Bankës i janë dhënë të dhëna, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, që nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj marrëveshjeje ndryshuese në emër të huamarrësit është autorizuar rregullisht dhe ratifikuar nëpërmjet të gjitha masave të nevojshme qeveritare, duke përfshirë ratifikimin parlamentar të kësaj marrëveshjeje ndryshuese; dhe

b) për qëllimet e seksionit 9.03 (a) të termave dhe kushteve standarde, mendimi ose mendimet e këshilltarit janë dhënë në emër të huamarrësit nga Ministri i Drejtësisë dhe janë në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

Seksioni 5. Garanci të tjera

Huamarrësi, me kërkesë të Bankës dhe me shpenzimet e veta, kryen të gjitha ato veprime dhe masa që janë të nevojshme ose të dëshirueshme për t'i dhënë fuqi ndryshimi të kryer ose që duhet të kryhet në pajtim me këtë marrëveshje ndryshuese.

Seksioni 6. Të ndryshme

a) Të gjitha referencat ndaj "marrëveshjes" në marrëveshjen fillestare dhe të gjitha referencat ndaj marrëveshjes fillestare në të gjitha instrumentet dhe marrëveshjet e nënshkruara sipas saj i referohen marrëveshjes fillestare të ndryshuar nga kjo marrëveshje ndryshuese.

b) Kjo marrëveshje ndryshuese dhe dokumentet e përmendura në të përbëjnë të gjithë detyrimin e palëve në lidhje me këtë objekt dhe mbizotëron mbi çdo shprehje qëllimi ose koncepti të mëparshëm në lidhje me objektin e tyre.

c) Kjo marrëveshje ndryshuese mund të ndryshohet vetëm me një instrument me shkrim, të nënshkruar rregullisht nga palët e saj.

d) Kjo marrëveshje ndryshuese mund të nënshkruhet në disa kopje, secila prej të cilave konsiderohet origjinale, por të gjitha së bashku përbëjnë të njëjtën marrëveshje.

e) Dispozitat e seksioneve 7.01 (Njoftimet) e marrëveshjes fillestare përfshihen dhe bëhen pjesë e kësaj marrëveshjeje ndryshimi nëpërmjet referencës, sikur të parashikoheshin plotësisht në të.

f) Të gjitha dispozitat e termave dhe kushteve standarde të Bankës të datës 1 maj 2006 përfshihen dhe bëhen të zbatueshme për këtë marrëveshje ndryshuese me të njëjtin efekt dhe fuqi sikur të ishin parashikuar plotësisht në të.

Në dëshmi të kësaj, palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht, kanë realizuar nënshkrimin dhe dorëzimin e kësaj marrëveshjeje ndryshuese në Tiranë, Shqipëri në datën e parë të shkruar më sipër.

Republika e Shqipërisë
Nga:_____
Emri: (Z. Ridvan Bode)
Titulli: (Ministër i Financave)

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
Nga:_____
Emri: (Zj. Sue Barrett)
Titulli: (Drejtore)

GRAFIK NDRYSHIMI I SHTOJCËS SË GRAFIKUT 2 TË MARRËVESHJES FILLESTARE

Tabela e mëposhtme zëvendëson tabelën fillestare në shtojcën e grafikut 2 të marrëveshjes fillestare:

Kategoria	**Shuma e huas e caktuar në monedhën e huas**	**Përqindja e shpenzimeve që duhet të financohen**
1) Punimet për pjesën B të projektit	Euro 29,205,000	50% e vlerës së kontratës duke përjashtuar tatimet
2) Komisioni fillim-mbarim	Euro 295,000	100%
Totali	**Euro 29.500.000**	

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE PËR VITIN 2011

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke konsideruar ILDKP-në një institucion me rol të rëndësishëm investigativ në parandalimin dhe ndëshkimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit në administratën publike;

- Duke vlerësuar çdo vit progresin dhe përpjekjet serioze jo vetëm në përmbushjen e objektivave ligjorë institucionalë, por edhe në përballjen e sfidave kundrejt ndryshimeve të legjislacionit shqiptar dhe rekomandimeve të BE-së;

- Duke dëshmuar vullnetin e Kuvendit të Shqipërisë për përmirësimin e legjislacionit në tërësi, me qëllim rritjen e efikasitetit në luftën kundër korrupsionit, informalitetit, krimit ekonomik, si dhe gatishmërinë dhe mbështetjen e vazhdueshme në drejtim të përmirësimit të punës së ILDKP-së;

Konstaton se për vitin 2011 ILDKP-ja:

- Ka forcuar kapacitetet investiguese-zbuluese të tij, përmes një pune profesionale dhe intensive.

- Ka zgjeruar aktivitetin ndërgjegjësues në të gjitha nivelet, në veçanti me qeverisjen vendore pas zgjedhjeve vendore, duke promovuar veprimtarinë e tij në institucionet publike.

- Ka synuar shtimin e ndikimit në vendimmarrjen e institucioneve publike në drejtim të fuqizimit të tyre, për të parandaluar dhe shmangur konfliktin e interesit.

- Ka dyfishuar numrin e gjobave për vonesa në afatet e deklarimit të interesave privatë dhe për parregullsi në deklarim.

- Ka ndëshkuar rastet e konfliktit të interesit, si dhe ka rritur numrin e referimeve dhe këshillimeve për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dyshuara për konflikt interesi.

- Ka vijuar me kallëzimet penale dhe me ndjekjen e të gjitha proceseve të tyre hetimore dhe gjyqësore.

- Ka shtuar të ardhurat me arkëtimin e gjobave dhe ka mirëmenaxhuar fondet buxhetore në dispozicion të veprimtarisë së tij institucionale.

- Ka forcuar bashkëpunimin me institucionet e tjera, veçanërisht me njësitë hetimore, si dhe me ato jashtë nivelit të njësive të përbashkëta hetimore, struktura të tjera të specializuara ligjzbatuese e përgjegjëse në luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik.

- Vazhdon të mbetet problem serioz dhe i vështirë konflikti i interesit, për sa kohë nuk koordinohet në nivel maksimal nga të gjitha hallkat dhe organet zbatuese të ligjit.

- Vazhdojnë të mbeten problem i vazhdueshëm dhe tepër shqetësues, i përsëritur vit pas viti, huamarrjet dhe huadhëniet.

- Mbetet problem serioz fshehja e pasurive, pasi kërkon hetime të specializuara brenda dhe jashtë vendit, por kapacitetet e ILDKP-së janë ende të pafuqishme në këtë drejtim.

Kërkon për vitin 2012:

- Forcimin e mekanizmave investigues për pasuritë e paluajtshme në terren dhe interesat privatë të zyrtarëve brenda dhe jashtë vendit.

- Rritjen e numrit të hetimeve administrative, të iniciuar kryesisht, si dhe nga denoncimet e qytetarëve, shoqërisë civile, medias, biznesit etj.

- Forcimin e vazhdueshëm të bashkëpunimit të ILDKP-së me institucionet brenda dhe jashtë njësive të përbashkëta hetimore, me institucionet e zbatimit të ligjit, me institucionet financiare, audituese e kontrolluese.

- Rritjen e autoritetit të kompetencës institucionale të ILDKP-së në mbledhjen e të dhënave në kohë të shpejtë dhe akses të ndërsjellë midis ILDKP-së dhe ZRPP-së, ALUIZNI-t, APP-së, KLSH-së, DPT-së, NIF-së, njësive doganore, bankave në shkëmbimin elektronik të të dhënave.

- Vijimin e trajnimeve të përbashkëta dhe tryezave me shkëmbim profesional, me gjyqtarë dhe prokurorë, lidhur me çështjet e hetimit, gjykimit të korrupsionit dhe konfliktit të interesit.

- Rritjen e efiçensës së kompetencave dhe menaxhimit të konfliktit të interesit nga autoritetet përgjegjëse të çdo institucioni publik, si dhe trajnimin e të gjitha kategorive të zyrtarëve në administratën qendrore e vendore, lidhur me konfliktin e interesit, rregulloret dhe kodet e etikës.

- Huazimin e praktikave më të përshtatshme me legjislacionin tonë për hetimin administrativ dhe përmasat e ndëshkueshmërisë, nëpërmjet punës së shtuar kërkimore dhe studimore.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

21 qershor 2012

DEKRET
Nr. 7579, datë 28.6.2012

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 05.08.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Rudina Sulejman Gjata (Majda)
2. Vanessa Eduart Gjata
3. Justin Eduart Gjata
4. Irena Murat Capo
5. Eduart Myftar Qorraj
6. Emiljano Myftar Qorraj
7. Rajmonda Riza Hysaj
8. Frensis Armir Sakollari
9. Sabina Lulzim Krajaj
10. Senad Lulzim Krajaj
11. Alexandra (Aleksandra) Adem Gjinia

12. Edona Qamil Gashi
13. Edita Qamil Gashi
14. Bardh Qamil Gashi
15. Ejona Qamil Gashi
16. Orjeta Arben Alija
17. Denis Ahmet Suti
18. Enrik Denis Suti
19. Marko Denis Suti
20. Andi Valentin Darragjati
21. Elert Pajtim Ajazaj (Ajazi)
22. Ledia Çapajev Pfefferkorn (Smokthina)
23. Minerva Hasan Bilali
24. Elca Mehmet Çelkupa (Baçi)
25. Teuta Besim Thunig (Rexha)
26. Erand Fatmir Karagjozi
27. Arta Riza Shkurtaj
28. Neritan Janaq Tërpo
29. Emanuela Vladimir Ustalli
30. Eskelida Fatmir Liebig (Koleci)
31. Klea Drini Lilaj
32. Lavdurie Bardhyl Kajmeni (Manjani)
33. Jurgen Gezim Kajmeni

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr. 419, datë 27.6.2012

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 205, DATË 13.4.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË KODIT DOGANOR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8449, date 27.1.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Emërtesa në shkronjën "b" të pikës 5.6 të nenit 5 të kreut I, titulli II, pjesa I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"b) Sektori i metodologjisë së vlerësimit doganor.".

2. Në nenin 18 të kreut 6, titulli II, pjesa I, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

- Në pikën 18.1.5, fjalët "… neni 606 …" zëvendësohen me "… neni 609 …".

- Në shkronjën "c" të pikës 18.2, fjalët "… pas rishqyrtimit, kur arsyet për këtë vendim mbështeten nga një raport me shkrim, …" hiqen.

- Pas pikës 18.2 shtohet pika 18.2.2 me këtë përmbajtje:

"18.2.2 Në rastet kur gjykohet dhënia e masës administrative "Largim nga puna", titullari i institucionit, pasi është shprehur në lidhje me rekomandimin e komitetit disiplinor, sipas pikës 18.2 të këtij vendimi, vetë ose përmes delegimit, zbaton procedurën, njoftimet dhe afatet e përcaktuara në nenin 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në veçanti, ai duhet:

a) të njoftojë me shkrim, në adresën e shtëpisë dhe adresën e punës, punonjësin doganor të paktën 72 (shtatëdhjetë e dy) orë para takimit dhe të bisedojë me të duke i parashtruar arsyet e vendimit të parashikuar për t'u marrë dhe duke i dhënë atij mundësi për t'u shprehur;

b) të njoftojë me shkrim punonjësin doganor në të dyja adresat e sipërpërmendura për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, brenda një afati nga 48 (dyzet e tetë) orë deri në një javë pas takimit.

Kjo procedurë zbatohet edhe në rastet e zgjidhjes së menjëhershme të marrëdhënieve të punës.".

- Pas pikës 18.5.1 shtohet pika 18.6., me këtë përmbajtje:

"18.6. Në të gjitha rastet e përfundimit të marrëdhënieve të punës, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duhet të zbatojë procedurën dhe afatet e njoftimit të paracaktuara në kreun XIV të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.".

3. Pika 7 e nenit 113 shfuqizohet.

4. Në kreun 2, titulli III, të bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

- Pas shkronjës "dh" të pikës 1 të nenit 247, shtohet shkronja "e", me përmbajtje:

"e) Përjashtimisht nga përcaktimi i shkronjës "d" të kësaj pike, për mallrat që hyjnë në magazinat e tipit C – *duty free shops* dhe *duty free*, në bordin e avionëve, nuk kërkohet garancia e parashikuar në shkronjën "d".".

- Pikat 5 dhe 10.4 të nenit 248, shfuqizohen.

5. Në titullin V, kreu I, seksioni 2, pas nenit 457 shtohet neni 457/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 457/1

1. Magazinat e lira të karburanteve në portet e përcaktuara për administrimin e lëndëve djegëse do të marrin në ngarkim produktet e marra në sasitë e matura në tokë nën mbikëqyrjen e doganës.

2. Me qëllim lehtësimin e mbikëqyrjes në magazinat e lira do të hyjnë: karburante, lëndë djegëse, lëndë të para për prodhimin e biodiezelit dhe karburante bio.

3. Pagesat e kryera nga operatorët ekonomikë, për efekt të zbatimit të pikës 7 të nenit 113 dhe pikave 5 dhe 10.4 të nenit 248, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi nuk rimbursohen nga autoriteti doganor.

4. Garancitë e depozituara, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nga magazinat e tipit C – *duty free shops*, për efekt të shkronjës "d" të pikës 1 të nenit 247, çlirohen menjëherë nga autoritetet doganore, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.".

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 436, datë 11.7.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 229, DATË 23.4.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E CEREMONIALIT ZYRTAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 12 të ligjit nr. 9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 3 të kapitullit IV "Ceremoniali zyrtar i autoriteteve më të larta të shtetit", të ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Kudo ku përmendet, emërtesa "...Pallati i Brigadave..." zëvendësohet me "...Selia e institucionit të Presidentit të Republikës...".

b) Pika 3.13 ndryshohet si më poshtë vijon:

"3.13. Drejtori i Protokollit të Shtetit fton kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, që, në mënyrë simbolike, t'i dorëzojë Presidentit të ri, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Gjatë dorëzimit, kryetari i Gjykatës Kushtetuese deklaron: "I nderuar zoti President, kam nderin t'Ju dorëzoj Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.".".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 38, datë 5.7.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	"	"
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	"	"
Petrit Plloçi	Anëtar i	"	"
Sokol Berberi	Anëtar i	"	"
Admir Thanza	Anëtar i	"	"
Fatmir Hoxha	Anëtar i	"	"
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	"	"

me sekretare Edmira Babaj, në datë 24.01.2012 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, me dyer të hapura, çështjen nr. 57/32 Akti që i përket:

KËRKUES: Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë, përfaqësuar nga avokati Baftjar Rusi, me autorizim.

Shoqëria "Titan Konstruksion" sh.p.k., përfaqësuar nga avokatja Enkeleda Hysa, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Sindikata e Pavarur e Ushqimit, përfaqësuar nga avokati Rustem Gjata, me deklarim.

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 00-2011-1117 (191), datë 21.4.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 15, 41/1, 42/1/2, 43, 131/f dhe 134/1/g dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i konventës europiane për të drejtat e njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Altina Xhoxhaj, përfaqësuesit e kërkuesve, që kërkuan pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, Sindikata e Pavarur e Ushqimit, që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në bazë të dekretit të Presidentit nr. 204, datë 5.6.1992 "Për pasurinë e sindikatave", Kampi i Pushimit të Punëtorëve Sarandë është regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Sarandë në pronësi të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH).

2. Në datën 15.5.1997, me kontratën e dhurimit nr. 2591 rep. dhe 1040 kol., BSPSH-ja ia ka dhuruar këtë pasuri Sindikatës të Pavarur të Ushqimit (SPU), kontratë e cila është regjistruar edhe në ZVRPP.

3. Në datën 18.5.2000, BSPSH-ja ka lidhur një kontratë qiraje me shoqërinë "Titan Konstruksion" sh.p.k., me anë të së cilës i jepte me qira 40% të objektit në fjalë. Shoqëria "Titan Konstruksion" i është drejtuar ZVRPP-së Sarandë për regjistrimin e kësaj kontrate, veprim që është refuzuar të kryhet nga kjo e fundit me arsyetimin se pasuria objekt kontrate rezulton e regjistruar në pronësi të SPU-së.

4. Shoqëria "Titan Konstruksion" sh.p.k. i është drejtuar gjykatës me padi, me objekt deklarimin e pavlefshmërisë së kontratës së dhurimit nr. 2591 rep. dhe 1040 kol, datë 15.05.1997, me pretendimin se në momentin e dhurimit BSPSH-ja nuk ka qenë pronare e vetme e sendit, por vetëm e 40% të tij.

5. Me vendimin nr. 386, datë 26.06.2000, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vendosur: "Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së dhurimit nr. 2591 rep. 1040 kol, datë 15.5.1997 dhe, duke i vlerësuar palët në mirëbesim, kthimin e tyre në gjendjen e mëparshme. Fshirjen e regjistrimit hipotekor të kontratës së sipërcituar në regjistrat e palës së paditur Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë. Detyrimin e palës së paditur Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, të regjistrojë kontratën e qirasë nr. 770 rep. 142 kol., datë 18.5.2000 në favor të shoqërisë "Titan Konstruksion" sh.p.k.".

6. Me vendimin nr. 81, datë 9.3.2005, Gjykata e Apelit Gjirokastër ka vendosur prishjen e vendimit nr. 386, datë 26.6.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

7. Me vendimin nr. 00-2007-627 (542), datë 02.05.2007, Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 81, datë 9.3.2005 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 386, datë 26.6.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

8. Me pretendimin se vendimi i mësipërm i Gjykatës së Lartë ishte jokushtetues, SPU-ja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e tij. Me vendimin nr. 8, datë 13.03.2008, Gjykata Kushtetuese, pasi i gjeti pretendimet e kërkuesit të pabazuara, vendosi rrëzimin e kërkesës.

9. Me kërkesën e datës 15.2.2008, SPU-ja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (të sipërcituara), bazuar në nenin 494/a të Kodit të Procedurës Civile (KPC), duke paraqitur si provë të re aktin e Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), të hartuar pas kontrollit të ushtruar prej tij në ZVRPP-në Sarandë.

10. Me vendimin nr. 00-2011-1117 (191), datë 21.4.2011, Gjykata e Lartë ka vendosur: "Pranimin e kërkesës për rishikim. Prishjen e vendimit nr. 542, datë 2.5.2007 të Gjykatës së Lartë,

vendimit nr. 81, datë 9.3.2005 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, vendimit nr. 386, datë 26.06.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me tjetër trup gjykues".

11. ***Kërkuesit, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë dhe shoqëria "Titan Konstruksion"*** sh.p.k., i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, me dy kërkesa të veçanta të datës 27.9.2011, me objekt shfuqizimin e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Lartë. Në mbështetje të nenit 1, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", në lidhje me nenin 57 të KPC-së, meqenëse kërkesat kanë lidhje dhe objekti është i njëjtë, Gjykata Kushtetuese vendosi bashkimin dhe shqyrtimin e tyre në një çështje të vetme.

12. Kërkuesit pretendojnë se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka pranuar kërkesën për rishikim, është pasojë e një procesi jo të rregullt ligjor dhe paraqesin, në mënyrë të përmbledhur, këto shkaqe:

12.1 Kërkesa për rishikim është paraqitur tej afatit prekluziv 1-vjeçar nga dita kur ka lindur shkaku për rishikim. Kërkuesi e ka paraqitur kërkesën në datën 15.02.2008 dhe pretendon se është vënë në dijeni të "provës së re" në datën 4.2.2008, ndërkohë që rezulton e provuar se ai ka marrë dijeni për aktin e kontrollit të KLSH-së në datën 24.02.2006. Gjykata e Lartë nuk ka paraqitur në mënyrë të drejtë dhe korrekte faktet e paraqitura në seancë në lidhje me datën e marrjes dijeni të këtij akti, duke cenuar në këtë mënyrë parimin e sigurisë juridike.

12.2 Është cenuar parimi i sigurisë juridike edhe për arsye se Gjykata e Lartë ka vlerësuar, duke u dhënë kuptim tjetër, fakte dhe prova që janë objekt shqyrtimi në vendimin e themelit.

12.3 Është cenuar parimi i paanshmërisë në gjykim, pasi në trupin gjykues që ka shqyrtuar këtë çështje në seancë gjyqësore kanë marrë pjesë dy gjyqtarë (G.Z. dhe M.F.), të cilët kanë marrë pjesë më parë në shqyrtimin e kërkesës për rishikim në Dhomë Këshillimi, ku është diskutuar dhe vendosur kalimi i saj për shqyrtim në seancë gjyqësore. Këto dy vendime lidhen me shqyrtimin e të njëjtit fakt, me të njëjtat subjekte dhe me të njëjtin konflikt gjyqësor. Parimi i paanshmërisë është cenuar edhe për arsye se shqyrtimi i kësaj çështjeje nuk është bërë nga gjyqtarët përkatës të caktuar, duke kuptuar me këtë trupin gjykues të formuar dhe shpallur publikisht. Gjykimi i çështjes ishte planifikuar në datën 17.3.2011 duke u shpallur edhe përbërja e trupit gjykues. Seanca u shty me shpallje në datën 21.4.2011 dhe ajo u çel me një trup tjetër gjykues dhe nuk u paraqit asnjë shpjegim lidhur me ndryshimin e kësaj përbërjeje.

12.4 Në rastin në shqyrtim nuk jemi para institutit të rishikimit të vendimit të formës së prerë, pasi nuk ka asnjë provë të re që nuk është ditur nga pala gjatë shqyrtimit të çështjes. Prova e re, e konsideruar si e tillë nga Gjykata e Lartë, jo vetëm që në formë nuk ka cilësinë e provës, por edhe në përmbajtje nuk ligjëron provën në kuptim të nenit 494/a të KPC-së.

12.5 Nëpërmjet shkeljes të së drejtës dhe interpretimit të gabuar të normave ligjore, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtat e fituara nëpërmjet një procesi të rregullt dhe të ligjshëm.

13. *Subjekti i interesuar, Sindikata e Pavarur e Ushqimit*, parashtroi para Gjykatës, në mënyrë të përmbledhur se:

13.1 Lidhur me çështjen e afatit të paraqitjes së kërkesës për rishikim, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se ky afat është respektuar. Pretendimi se subjekti i interesuar është njoftuar për aktin e kontrollit në vitin 2006, nuk mbështetet në asnjë provë, pasi nuk vërtetohet marrja dijeni në atë kohë.

13.2 Pretendimin për paanshmërinë e gjyqtarëve të Kolegjit Civil kërkuesit duhet ta kishin ngritur në fillim të procesit gjyqësor, në çastin kur u shpall përbërja e trupit gjykues. Përbërja e kolegjit që shqyrton çështjen në Dhomën e Këshillimit nuk mbetet e fshehtë dhe kërkuesit kishin kohë, deri në zhvillimin e seancës gjyqësore, të verifikonin të dhënat për gjyqtarët përkatës, përmes sekretarisë gjyqësore të Gjykatës së Lartë. Edhe në thelb ky pretendim nuk qëndron, pasi në Dhomën e Këshillimit nuk shqyrtohet çështja në themel, por bëhet vetëm verifikimi nëse kërkesa plotëson ose jo shkaqet ligjore.

13.3 Lidhur me pretendimin se nuk mund të konsiderohet provë e re akti i kontrollit të KLSH-së, vlerësojmë se ky organ ka zbuluar vetëm faktin e kalimit të pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme në bazë të vendimeve gjyqësore për regjistrimin e personave juridikë dhe ndryshimeve që ata pësojnë.

13.4 Çështjet e tjera të ngritura në kërkesë kanë të bëjnë më vlerësimin e provave dhe si të tilla nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues.

II

A. Lidhur me legjitimimin e kërkuesve për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese

14. Bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për shkeljen e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Gjykata ka theksuar se juridiksioni kushtetues për shkeljen e së drejtës themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuesi shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor, çka nënkupton që kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës të pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 17, datë 18.7.2005; nr. 1, datë 25.1.2010; nr. 17, datë 16.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata ka vlerësuar se në rastet kur kundërshtohet procesi i rishikimit i zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për vetë specifikën e këtij lloj gjykimi, duke qenë se rishikimi është mjet i jashtëzakonshëm dhe vendimi i Gjykatës së Lartë është përfundimtar, kërkuesi nuk ka mjet tjetër për të goditur vendimin që ka pranuar kërkesën për rishikim dhe ka vendosur prishjen e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimet nr. 17, datë 18.7.2005; nr. 5, datë 26.1.2007; nr. 6, datë 16.2.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

Për sa më sipër, edhe në lidhje me çështjen konkrete në shqyrtim, Gjykata vlerëson se kërkuesit i kanë shteruar mjetet ligjore, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës dhe se pretendimet e ngritura në kërkesë duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit kushtetues.

B. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike

15. Kërkuesit pretendojnë se është cenuar parimi i sigurisë juridike, për arsye se kërkesa për rishikim është paraqitur tej afatit prekluziv 1-vjeçar nga dita kur ka lindur shkaku për rishikim dhe, në këto kushte, ajo nuk duhej të pranohej për shqyrtim. Sipas tyre, rezulton e provuar se SPU-ja ka marrë dijeni kohë më parë për akt kontrollin e KLSH-së dhe se ky akt i është komunikuar asaj që në vitin 2006.

16. Gjykata ka pranuar se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve ligjore të përcaktuara. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën një qëllim në vetvete, por bëhet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe në funksion të parimit të sigurisë juridike. Mospërcaktimi i këtyre afateve do të çonte në një situatë të tillë ku konfliktet gjyqësore asnjëherë nuk do të zgjidheshin përfundimisht mes palëve dhe situata e tyre do të ishte e pasigurt, pasi në çdo moment, një e drejtë e fituar me një vendim gjyqësor, potencialisht do të mund të cenohej apo prekej me një vendim të dhënë nga një gjykatë më e lartë (*shih vendimin nr. 5, datë 2.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Neni 445 i KPC-së parashikon se: *"ankimi në gjykatën e apelit, rekursi në Gjykatën e Lartë dhe rishikimi nuk mund të bëhen pasi ka kaluar një vit nga shpallja e vendimit", kurse neni 496 i KPC-së parashikon se: "kërkesa për rishikim mund të paraqitet brenda 30 ditëve nga dita që pala ka marrë dijeni për shkakun e rishikimit, por në çdo rast jo më vonë se një vit nga dita që ka lindur shkaku i rishikimit."* Këto dy dispozita dallojnë nga njëra-tjetra sepse: i) neni 445 sanksionon prekluzivitetin (afatin) e ankimit si mjet procedural për të gjitha llojet e ankimit, përfshirë dhe kërkesën për rishikim, duke pasur parasysh se zë vend në titullin e parë të pjesës së tretë të Kodit, kurse neni 496 sanksionon afatin ligjor vetëm për sa i përket kërkesës për rishikim që zë vend në titullin e tretë të pjesës së tretë të Kodit; ii) neni 445 përcakton vetëm ankimin njëvjeçar nga shpallja e vendimit, kurse neni 496 përcakton afatin njëvjeçar që nga dita që ka lindur shkaku i rishikimit; iii) neni 445 nuk ka si qëllim përcaktimin e afatit për ankim, ndërsa neni 496 saktëson afatin 30-ditor, si determinant nga dita që pala ka marrë dijeni për shkakun e rishikimit. Gjykata ka vlerësuar se në rastet e paraqitjes së kërkesës për rishikimin e një vendimi të formës së prerë, neni 445 i KPC-së duhet të zbatohet në harmoni me nenin 496 të KPC-së për sa i përket afatit prekluziv njëvjeçar, për pasojë paraqitja e kërkesës tej këtij afati e bën atë të papranueshme. Pra, ky afat llogaritet ose nga momenti që është shpallur vendimi që ankimohet ose nga momenti që merr formë të prerë vendimi që përmban shkakun e rishikimit të parashikuar nga neni 494 i KPC-së. Nëse nuk

do të interpretohej në këtë mënyrë, neni 445 i KPC-së ashtu si është shkruar do të ishte i paaplikueshëm, duke ia ngushtuar hapësirat individit për të pasur akses në gjykatë dhe për të shfrytëzuar mjetin procedural të jashtëzakonshëm të kërkesës për rishikim (*shih vendimin nr. 20, datë 29.9.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës së Lartë autoritetin të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore, pra të mbajë qëndrime në çështje të veçanta me qëllim unifikimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme. Ky funksion ushtrohet nga Gjykata e Lartë, duke tërhequr për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara. Sa më sipër, vjen si pasojë e pozicionit të saj si organi më i lartë i sistemit gjyqësor dhe lidhet me funksionin e përgjithshëm të saj për të siguruar uniformitetin e interpretimit të normave ligjore nga ana e gjyqtarëve të zakonshëm, përmes përcaktimit të linjave të interpretimit të cilave gjyqtarët duhet t'u përmbahen. Përfundimet në të cilat arrin Gjykata e Lartë nuk vlejnë vetëm për rastin konkret të zgjidhur prej saj, por për të gjitha rastet e ngjashme për gjykatat e tjera, ose vetë kolegjet e thjeshta të asaj gjykate. Barazia në të drejta, mes të tjerash, përcakton edhe detyrimin për vendimmarrje të njëjtë dhe të qëndrueshme në çështje të ngjashme nga gjykatat e zakonshme (*shih vendimin nr .6, datë 17.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në lidhje me afatin e kërkesës për rishikim, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se ligjvënësi e ka klasifikuar kërkesën për rishikim në mjetet për t'u ankuar ndaj vendimeve të gjykatave, krahas apelit dhe rekursit (neni 442 i KPC-së), si dhe ka përcaktuar të njëjtin afat prekluziv njëvjeçar për të tria llojet e ankimeve (neni 445 i KPC-së). Ky afat prekluziv (dekadence) llogaritet nga momenti që është shpallur vendimi që ankimohet, apo vendimi i formës së prerë që përmban shkakun e rishikimit, sipas rasteve të parashikuara në nenin 494 të KPC-së. Pavarësisht nga shkaku i rishikimit, fillimi i afatit 30-ditor nga dita e marrjes dijeni për të, si dhe i afatit 1-vjeçar nga dita që ka lindur shkaku i rishikimit, është i njëjtë për të gjitha rastet që përbëjnë shkak rishikimi të një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Këto afate, duke qenë afate prekluzive (dekadence), nuk mund të pezullohen, të ndërpriten apo të rivendosen (*shih vendimin unifikues nr. 8, datë 24.03.2005 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*).

20. Në lidhje me çështjen konkrete në shqyrtim, bazuar në dosjen gjyqësore, Gjykata vëren se me shkresën e datës 24.10.2006, KLSH-ja i ka dërguar edhe Presidentit të SPU-së aktin e verifikimit të kryer nga ky institucion në ZVRPP-në Sarandë. Po ashtu, rezulton se me shkresën e datës 4.2.2008, KLSH-ja i ka dërguar SPU-së, sipas kërkesës së kësaj të fundit të datës 15.1.2008, një kopje të rezultateve të po këtij kontrolli të ushtruar në ZVRPP-në Sarandë. Është pikërisht data 04.02.2008, që mban shkresa e KLSH-së, e cila është konsideruar nga Gjykata e Lartë si momenti i marrjes dijeni nga SPU-ja për provën e re me shkresë, duke e vlerësuar kështu kërkesën si të paraqitur brenda afatit ligjor një mujor nga marrja dijeni dhe atij një vjeçar nga shpallja e vendimit, por duke shmangur vlerësimin e saj lidhur me afatin tjetër, të përcaktuar në nenin 496 të KPC-së, atë një vjeçar nga lindja e shkakut të rishikimit.

21. Duke pasur parasysh përmbajtjen e dispozitave procedurale që rregullojnë afatet për ushtrimin e mjeteve të ankimit, dhe më specifikisht ato që rregullojnë kërkesën për rishikim, si dhe interpretimin që u është bërë atyre nga jurisprudenca e kësaj Gjykate dhe ajo e Gjykatës së Lartë, Gjykata vëren se momenti i lindjes së shkakut të rishikimit është data 24.10.2006. Edhe pse Gjykata e Lartë ka vlerësuar se subjekti i interesuar ka ushtruar kërkesën për rishikim brenda afatit 30-ditor nga marrja dijeni dhe atij njëvjeçar nga shpallja e vendimit që kërkohet të rishikohet, ajo Gjykatë nuk ka marrë në konsideratë një afat tjetër prekluziv, i cili lidhet me momentin e lindjes së shkakut të rishikimit. Gjykata vlerëson se kërkesa për rishikim është paraqitur më vonë se një vit nga lindja e shkakut të rishikimit, pra tej afatit ligjor prekluziv të përcaktuar në nenin 496 të KPC-së, dhe Gjykata e Lartë, duke e pranuar një kërkesë të tillë si të paraqitur brenda afateve ligjore, u ka cenuar kërkuesve të drejtat e fituara me vendime gjyqësore të formës së prerë, duke cenuar në këtë mënyrë parimin e sigurisë juridike.

Për sa më sipër, ky pretendim i kërkuesve është i bazuar dhe duhet të pranohet.

C. Lidhur me pretendimet e tjera të paraqitura nga kërkuesit

22. Në lidhje me pretendimet e tjera të paraqitura në kërkesë, më konkretisht për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, parimit të sigurisë juridike për arsye se i janë dhënë kuptim tjetër fakteve dhe provave që janë objekt shqyrtimi në vendimin e themelit, se në rastin në shqyrtim nuk jemi

para institutit të rishikimit të vendimit të formës së prerë, pasi nuk ka asnjë provë të re që nuk është ditur nga pala gjatë shqyrtimit të çështjes etj, Gjykata vlerëson se përderisa ka konstatuar më sipër se procesi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë ka qenë jokushtetues, për shkak të pranimit të një ankimi të paraqitur jashtë afatit ligjor, ajo nuk e sheh të arsyeshme të ndalet në vlerësimin e pretendimeve të tjera të ngritura nga kërkuesit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f" dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 00-2011-1117 (191), datë 21.4.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Admir Thanza, Sokol Berberi, Petrit Plloçi, Altina Xhoxhaj,Fatmir Hoxha.

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 23.7.2012
Doli nga shtypi më 23.7.2012

	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 22 lekë